

ll. 98 Prot  
ef. 02.2014



9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

Nr. 905 / Prot.  
2

Tiranë, më 04.02.2014

**LËNDA:** DËRGIM I RAPORTIT FINAL DHE KËRKESËS PËR REAGIM ME FORMATIN PËRKATËS, NË LIDHJE ME MISIONIN E AUDITIMIT TË REALIZUAR NGA DATA 11.11.2013 DERI MË DATËN 27.11.2013

**DREJTUAR :** UNIVERSITETIT TË ARTEVE

TIRANË


Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshime dhe “Manualit të auditimit”, bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Raportin final të auditimit
- Kërkesën për reagim mbi misionin e auditimit
- Formatin standard “Anketa për reagimet nga auditimi”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

PLARENT NDRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

**UNIVERSITETI  
I ARTEVE  
RAPORT FINAL**

**GRUPI I AUDITIT**

**VJOLLCA HAXHIU**

**JETON SHEHU**

**RAPORT FINAL**  
**MBI**  
**AUDITIMIN NË UNIVERSITETIN E ARTEVE TIRANË**

Në zbatim të programit të auditimit nr. 905, datë 06.11.2013, gjatë muajit nëntor 2013, në Universitetin e Arteve Tiranë u krye auditimi, me objekt "Auditim mbi bazë sistemi (Të përputhshmërisë, të performancës dhe financiarë). U auditua periudha 01 janar 2012 deri 30 shtator 2013. Gjatë realizimit të misionit u bë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe ekspozimin e njësisë ndaj riskut.

Qëllimi i misionit është dhënia e sigurisë objektive dhe menaxhimin e riskut në funksion të realizimit të objektivave duke siguruar dobi, frytshmëri dhe kursim të fondeve publike.

Në përfundim të misionit u përpilua projektraporti, për të cilin drejtuesit e universitetit janë shprehur pa vërejtje me shkresën nr.12, datë 13.01.2014.

***Në mënyrë të përmbledhur nga misioni i auditivit rezultoi se:***

- Struktura organizative e subjektit dhe organigrama janë në përputhje me rregullimet normative.
- Sistemi i listë-pagesave është në përputhje me legjislacionin në fuqi, me procedurat dhe me politikën e menaxhimit.
- Procedurat e kontrollit të vendosura nga subjekti kanë siguruar rregullshmëri, përputhshmëri me kuadrin ligjor duke parandaluar dhe zbuluar mashtrimin nëpërmjet drejtimit.
- Janë bërë rakordimet periodike me sistemin e thesarit lidhur me pagesat dhe transferimet përkatëse.
- Blerjet janë bërë sipas kërkesave dhe nga personat e autorizuar, janë bërë hyrje dhe janë marrë në evidencën kontabile.
- Likuidimi i blerjeve është bërë sipas faturave të konfirmuara dhe nga llogarit buxhetore përkatëse.
- Si konkluzion i përgjithshëm rezulton se në Universitetin e Arteve Tiranë bëhet një punë e mirë në mbajtjen e evidencës kontabile dhe zbatimin e legjislacionit në prokurimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore dhe fondeve të krijuara nga vetë universiteti.
- Sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë duke shërbyer realizimit të objektivave me kosto të ulët.

Auditimi u realizua nga z. Jeton Shehu dhe z. Vjollca Haxhiu.

Në përfundim të misionit, u përpilua projektraporti, për të cilin menaxhimi i Universitetit me shkresën nr.12, datë 13.01.2014 janë prononcuar pa vërejtje.

Bazuar në dokumentacionin e audituar, sipas çështjeve të programit të auditimit rezultoi:

### **1.-ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMI I MËPARSHËM.**

Auditimi i fundit në Universitetin e Arteve, Tiranë është realizuar nga grupi i auditit të MASH. Është audituar periudha deri 31 dhjetor 2011. Me shkresë të MASH në institucion ka ardhur raporti përfundimtar i auditimit sipas të cilit rezulton se nuk janë lënë rekomandime.

### **2.-AUDITIM I ZBATIMIT TË PROCEDURAVE LIGJORE NË LLOGARITJEN DHE SHPËRNDARJEN E PAGAVE.**

Nga auditimi rezultoi se me shkresën të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve.

U auditua me zgjedhje dokumentacioni i vënë në dispozicion nga entiteti dhe rezultoi se:

- Sistemi i listë-pagesave është në përputhje me legjislacionin në fuqi, me procedurat dhe me politikën e menaxhimit.
- Struktura organizative e subjektit dhe organigrama janë në përputhje me rregullimet normative.
- Orët e punës së personelit, personat që largohen, pagat dhe ndalesat e pagave janë autorizuar siç duhet.
- Listë-prezencat, rishikohen, miratohen, përpunohen, dokumentohen dhe regjistrohen qartë.
- Pagesat bruto, ndalesat dhe pagesat neto janë të sakta dhe në bazë akteve normative në fuqi.

Rektori ka miratuar numrin e punonjësve sipas njësive organizative të njësive, për vitin 2011-2012 dhe 2012-2013.

U auditua struktura analitike e zbatuar dhe rezultoi se është në përputhje me numrin e punonjësve të miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit.

Në mënyrë analitike për strukturën shprehemi sa më poshtë:

Në bazë të ligjit 10 307, datë 22.07. 2010, 'Për disa ndryshime në ligjin e Arsimit të Lartë nr.9741, datë 21.05.2007', neni 16, pika 2/ç, Këshilli i Administrimit ka kompetencë të miratojë strukturën dhe numrin e punonjësve të Institucionit për të gjitha nivelet.

Më tej Ligji i Arsimit të Lartë, në nenin 47, pika 4 përcakton se numri i përgjithshëm i personelit në çdo institucion publik të arsimit të lartë miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

a. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në përgjigje të kërkesës së universitetit me nr. 274 prot, datë 27/03/2013 "Kërkesë për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve për vitin 2013 në UART", me shkresën e saj nr.1656/1 prot, datë 29/03/2013, Miraton numrin e përgjithshëm të personelit për vitin 2013, në 215 (dyqindpesëmbëdhjetë) punonjës.

Senati Akademik me Vendimin e tij Nr.13, datë 25.11.2013 "Për miratimin e strukturës përfundimtare dhe miratimin e ndarjes në nivele e kategori të pozicioneve të punës për personelin akademik në Universitetin e Arteve", Miraton strukturën përfundimtare me ndarje në nivele e kategori, të pozicioneve të punës për personelin akademik.

Tabela e Strukturës organike dhe analitike, ka pësuar ndryshimet sipas kualifikimeve të punonjësve mësimorë mbështetur në VKM 331, sipërpërmendur, propozuar nga fakultetet dhe miratuar nga Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit.

Për të gjitha njësitë e Universitetit është përpiluar rregullorja e funksionimit të tyre

Me vendim të senatit është bërë ndarja në nivele e kategori të pozicioneve të punës për personelin akademik të Universitetit të Arteve.

Të gjitha pagesat janë bërë në kohë, të plota dhe të sakta. Llogaritjet janë bërë në përputhje me caktimet e akteve normative në fuqi. Nuk rezulton se ka devijime dhe anomali.

U auditua edhe menaxhimi i burimeve njerëzore në përgjithësi dhe rezultoi se;

- Ekzistonin skeda të veçanta për çdo punonjës si dhe regjistrohej e monitorohej lëvizjet e personelit.
- Për çdo marrje në punë hartohej kontrata e punës në të cilën caktohen kushtet e punës dhe të shpërblimit.
- Gjithë procedura e rekrutimit bëhej kundrejt rregullave të përcaktuar qartësisht në statutin e universitetit të Arteve Tiranë.
- Rekrutimi kryhet me konkurrim publik, dhe sipas procedurave si me poshtë:
- Për vendet e lira konkurrimi shpallet nga Rektorati në buletin e njoftimeve publike sipas kërkesave të VKM nr. Nr. 173 , datë 7.3.2003 "Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave , Kryeministrit ose të ministrit"

- Për vendet e lira në fakultete, titullari i njësisë kryesore të fakultetit (dekani) përkatës, ka përgatitur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të pozicioneve të lira. Pas kësaj procedure konkurrentët të cilët kanë dorëzuar dosjet e tyre personale pranë degës së burimeve njerëzore, brenda afatit të përcaktuar në kriteret e publikuara, janë njoftuar për ditën e konkursit.
- Vlerësimi i kandidatëve që konkurrojnë për një vend në personelin akademik është bërë nga komisione të posaçme (ad hoc). komisionet janë ngritur me urdhër të dekanit të fakultetit. për ngritjen e komisionit, dekani ka emëruar 2/3 e anëtarëve të komisioneve nga stafi akademik në fakultet dhe 1/3 e anëtarëve të komisionit, përzgjidhen nga personat e caktuar nga rektori dhe të njoftuar me akt zyrtar.
- Kualifikimi i kandidatëve është bërë duke u bazuar në kriteret e shpallura publikisht.
- Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht, prej secilit prej anëtarëve dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.
- Rezultatet e vlerësimit dhe renditja e aplikantëve janë shpallur publikisht. Aplikantëve u është garantuar e drejta të ankimojnë vlerësimin dhe rezultatet e konkursit, duke paraqitur kërkesë formale dhe duke parashtruar arsyet dhe shkaqet për të cilat paraqesin ankimin, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve.

Për emërimin e personelit akademik, autoriteti drejtues i njësisë kryesore i paraqet autoritetit drejtues të institucionit të arsimit të lartë kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni ad hoc i konkursit publik, i krijuar nga autoriteti drejtues i njësisë kryesore.

Autoriteti drejtues i institucionit të arsimit të lartë, pasi shqyrton dokumentacionin e komisionit Ad Hoc (Proces – Verbalet, Vendimet) dhe vlerësimin për çdo kandidat, Vendos në përzgjedhjen e kandidaturave paraqitur nga Komisioni Ad Hoc dhe lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur. Kontrata përmban përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 96 të Statutit.

Për vitin 2013 për rekrutimin e punonjësve u gjet praktika sa më poshtë: Në bazë të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipëri”, i ndryshuar, neni 18, 97, 98 e vijues, e 100 të Statutit të Universitetit të Arteve, duke pasur në konsideratë faktin se marrja në punë e personelit akademik në këtë institucion kryhet me konkurrim publik kryen në radhe procedurat e poshtëshënuara:

- ✚ Për vendet e lira konkurrimi shpallet nga Rektorati, duke përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Për vendet e lira në Fakultete, Titullari i njësisë kryesore të Fakultetit (Dekani) përkatës, përgatit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat ia njofton Rektorit. Rektorati bën shpalljen përkatëse. Në faqen e internetit të Universitetit të Arteve dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike (APP). Pas kësaj procedure konkurrentët të cilët kanë dorëzuar dosjet e tyre personale pranë Degës së Burimeve Njerëzore të UART, brenda afatit të përcaktuar në kriteret e publikuara, njoftohen për ditën e konkursit.
- ✚ Vlerësimi i kandidatëve që konkurrojnë për një vend në personelin akademik të UART, bëhet nga komisione të posaçme (Ad Hoc). Komisionet ngrihet me urdhër Dekanit të Fakultetit. Për ngritjen e Komisionit, Dekani emëron 2/3 e anëtarëve të Komisioneve pasi përzgjedh ndër personelin akademik të Fakultetit, me dije në fushën për të cilën zhvillohet konkursi. Dekani emëron 1/3 e anëtarëve të Komisionit, personat e caktuar nga Rektori dhe të njoftuar me akt zyrtar.
- ✚ Kualifikimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e shpallura publikisht. Eksperienca dhe formimi i kandidatëve të kualifikuar, duhet ti përgjigjen sa më mirë përshkrimit të vendit të punës.
- ✚ Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht, prej secilit prej anëtarëve dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.
- ✚ Rezultatet e vlerësimit dhe renditja e aplikantëve shpallen publikisht. Aplikantëve u garantohet e drejta të ankimojnë vlerësimin dhe rezultatet e konkursit, duke paraqitur kërkesë formale dhe duke parashtruar arsyet dhe shkaqet për të cilat paraqesin ankimin, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve. Ankimi paraqitet tek Rektori i UART, i cili e shqyrton dhe vendos mbi ankimin brenda 30 ditëve. Gjatë shqyrtimit të ankimeve zbatohen nga pikëpamja e së drejtës procedurat e përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
- ✚ Për emërimin e personelit akademik, autoriteti drejtues i njësisë kryesore i paraqet autoritetit drejtues të institucionit të arsimit të lartë kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni ad hoc i konkursit publik, i krijuar nga autoriteti drejtues i njësisë kryesore.

- ↓ Autoriteti drejtues i institucionit të arsimit të lartë, pasi shqyrton dokumentacionin e komisionit Ad Hoc (Proçes – Verbalet, Vendimet) dhe vlerësimin për çdo kandidat, Vendos në përzgjedhjen e kandidaturave paraqitur nga Komisioni Ad Hoc dhe lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur, mbështetur në këtë ligj dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata përmban përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 96 të këtij Statuti. Mësimdhënia është detyrim, si rregull, me së paku 6 orë mësim në javë në auditor për të gjithë personelin akademik.

Për vitin 2013 janë rekrutuar me procedurat e sipërcituara, personel akademik si më poshtë:

Xhevdet Ferri, për pozicionin e punës Lektor në Fakultetin e Artit Skenik, për programin e studimit Aktrim;

Rozina Kostani, për pozicionin e punës Lektor në Fakultetin e Artit Skenik, për programin e studimit Regjiturë;

Elton Balla, për pozicionin e punës Lektor në Fakultetin e Muzikës, Programin e Studimit Fizarmonikë.

Procedurat sa sipër vlerësohen të rregullta.

### **3.-AUDITIM I LIGJSHMËRISË TË KRYERJES SË VEPRIMEVE ME THESARIN DHE BUXHETIN.**

Urdhërpagesat janë të plotësuara në rregull, duke respektuar formularin standard të miratuar për këtë qëllim.

Urdhërpagesat janë të firmosura dhe të vulosura nga dega e thesarit në rreth dhe veprimet janë të kontabilizuara sipas rregullave të kontabilitetit.

Veprimet e kryera me anën e llogarive bankare janë të rregullta.

Në çdo fillim viti nga titullari i enti prokurues është nxjerrë Urdhër për ngritjen e Komisionit për Blerjet e Vogla, i cili ka funksionuar gjatë gjithë periudhave ushtrimore që është autorizuar.

Funksionimi i komisionit u gjet ne përputhje me kërkesat e VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Nga auditimi i praktikave dokumentare rezultoi se janë bërë blerje dhe për çdo likuidim të kryer, bashkëngjitur dokumentacionit është, urdhri i prokurimit, procesverbali i komisionit, tre ofertat e mara nga operatorët, fletëdalje faturë e shitësit me ekstremitetet përkatëse si dhe fletëhyrja e magazinës.

Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit në këtë institucion, janë zbatuar kërkesat e Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe udhëzimet e Ministrisë së Financës në lidhje me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ka dërguar treguesit e planit të buxhetit për vitin 2012, si vjetor dhe limit mujor të planifikuar për shpenzime korente. Gjatë vitit ka ndryshime në artikujt buxhetor të planifikuar 600 “Pagat e punonjësve”, artikullin 601 “Sigurimet shoqërore” dhe 602 “Mallra dhe shërbime”, për të cilat është respektuar autoriteti.

Sipas situacionit përfundimtar, të rakorduar edhe me degën e thesarit, realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2012 është në kufijtë e planifikuar.

Respektimi i disiplinës buxhetore në artikuj, kapituj dhe tituj.

Pagesat janë bërë duke respektuar limitet e strukturës buxhetore të planifikuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe me udhëzimet e Ministrisë së Financave të nxjerra për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2012.

Për periudhën e audituar, evidentimi i shpenzimeve të kryera është bërë drejtë, sipas titullit, kapitullit e artikujve të miratuar dhe nuk ka tejkalime në nivel artikulli.

Situacionet progresiv të shpenzimeve për periudhën janë të rakorduara me degën e thesarit.

Në mënyrë të detajuar e të zbërthyer buxheti për vitin 2012 paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë

Llog.	Emërtimi	Plani	Fakti	Ne %
600	Paga	238,974	232,577	97%
601	Sigurime shoqërore	30,086	30,086	100%
602	Mallra dhe shërbime	29,121	27,946	96%
605	Kuota anëtarësie	150	118	79%
606	Transferta të individët	5,165	5,164	100%
231	Investime	36,005	32,639	91%
	<b>TOTALI</b>	<b>339,501</b>	<b>328,531</b>	<b>97%</b>

Fondet e akorduara nga buxheti për vitin 2012 janë realizuar në masën 97% ose në vlerë absolute 10.970 mijë lekë më pak.

Investimet janë realizuar 91%.

Në mënyrë të detajuar e të zbërthyer buxheti për periudhën Janar-Shtator 2013 paraqitet si më poshtë;

Në 000/lekë

Llog.	Emërtimi	Plani	Fakti	Ne %
600	Paga	230,130	171,588	<b>75%</b>
601	Sigurime shoqërore	30,246	22,715	<b>75%</b>
602	Mallra dhe shërbime	31,282	14,552	<b>47%</b>
605	Kuota anëtarësie	278	120	<b>43%</b>
606	Bursa e tjera	5,030	3,652	<b>73%</b>
231	Investime	2,639	1,271	<b>48%</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>299,606</b>	<b>213,897</b>	<b>71%</b>

Të ardhurat dytësore

Auditimi i procedurave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore është bërë bazuar në klasifikimin dhe administrimin e përcaktuar sipas VKM nr.432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore" dhe udhëzimit të MASH-it nr. 33, datë 10.10.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

Për vitin 2012 janë realizuar gjithsej 34935 mijë lekë të ardhura dytësore. Limiti i çelur për vitin 2012 është 34827 mijë lekë.

Nr.	Emërtimi	Vlera (lek)
1	Tarifa Shkollimi	26,282
2	Shërbim salle	2,325
3	Konkurse pranimi	1,550
4	Qira ambiente	2,062
5	Libreza e diploma	170
6	Tarifa regjistrimi	784
7	Shtypshkrime, libreza Vërtetime.etj	162
8	Kurse pasuniversitare FM	1,600
	Te Ardhura te realizuara	34,935
	Te Ardhura te planifikuara	40,438
	% e realizimit	86.39%

Për periudhën Janar-Shtator 2013, janë realizuar gjithsej 42304 mijë lekë të ardhura dytësore.

Nr.	Emërtimi	Vlera (lek)
1	Tarifa Shkollimi	36,505
2	Shërbim salle	2,025
3	Konkurse pranimi	2,300
4	Qira ambiente	1,054
5	Libreza,diploma	257
6	Tarifa regjistrimi	2
7	Shtypshkrime,vërtetime etj	161
	<b>Te Ardhura te realizuara</b>	<b>42,304</b>
	<b>Te Ardhura te planifikuara</b>	<b>51,065</b>
	<b>% e realizimit</b>	<b>82.84%</b>

Të ardhurat e krijuara janë derdhur në llogarinë e njësisë, sipas ligjit të arsimit të lartë.

Përdorimi i tyre, mbas rakordimit me degën e thesarit bëhet në bazë të autorizimeve buxhetore për çdo lloj shpenzimi. Në fund të vitit 2012 kanë mbetur pa u përdorur fonde, të cilat sipas ligjit të arsimit të lartë, neni 72 pika 2, përdoren tërësisht nga vetë institucioni dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës.

Universiteti i Arteve ka dhënë me qira disa ambiente dhe ka realizuar të ardhurat nga arkëtimi i qirasë.

Për vitin 2012

Nr	Subjekti	Emërtimi i objektit të dhënë me qera	Aktiv.	Sip. M2	Data e lidhjes së kontratës	Afati	Shuma qerash mujore	Vlera e qerash që duhet të arkëtohet	Vlera e qerash të arkëtuara dhe të kontabilizuara
						1	3	4=(2*3)	5
1	Vodafone Albania	Tarrace	Telekomunikacion	30	25.10.2011	1	33,333	400,000	Shuma prej 400.000 lekë është paguar paradhënie në momentin e lidhjes së kontratës në vitin 2011

2	Eagle Mobile	Tarrace	Telekomunikacion	40	17.04.2012	1	58,333	700,000	700.000
3	Corner shpk	Godine	Bar-kafe	70	22.11.2011	1	17,500	192.500	192.500
4	Corner shpk	Godine	Bar-kafe	70	22.11.2012	1	17,500	17.500	Subjekti me datë 23.01.2013 ka shlyer gjithë detyrimin që rjedh nga kontrata për periudhën deri 21.11.2013 me vlerë 210.000 lekë
5	House of Arts shpk	Bodrum i nendhes hem	Bar-kafe	628	08.03.2001	15	62,525	750.298	750.298
<b>shum</b>								<b>2.060.298</b>	<b>2.042.798</b>

Për vitin 2013 (Periudha Janar – shtator 2013)

Nr	Subjekti	Emerti mi i objektit te dhene me qera	Aktiv.	Sip . M2	Data e lidhjes se kontrates	Afati	Shuma qerese mujore	Vlera e qerese qe duhej te arketohet	Vlera e qerese e arketuar dhe e kontabilizuar	Shenime
						1	3	4=(2*3)	5	6
1	Vodafone Albania sha	Tarrace	Telekomunikacion	30	16.10.2012	1	33,333	300,000	-	Shoqeria, si dhe parashikohet ne kontrate, ne momentin e lidhjes se kontrates realizon parapagin tere pagesen. Keshtu qe pagese per periudhen 01.11.2012-30.11.2013 e ka paguar ne vitin 2012.

2	Eagle Mobile sha	Tarrace	Telekomunikacion	40	17.04.2012	1	58,333	525,000	350,000	Shoqeria, si dhe parashikohet ne kontrate, ne momentin e lidhjes se kontrates realizon parapagim 6-muaj. Keshtu qe pagesen per periudhen 16.10.2012-16.04.2013 ne vitin Nentor te viti 2012.
3	Corner shpk	Godine	Bar-kafe	70	22.11.2012	1	17,500	157,500	210,000	Shoqeria ka realizuar parapagim. Pagesa eshte realizuar deri me date 25.11.2013
4	House of Arts shpk	Bodrum I nendhes hem	Bar-kafe	628	08.03.2001	15	61,655	554,898	494,223	Si dhe shte parashikuar ne kontrate, per muajin Shtator 2013 shoqeria ka paguar me date 07.10.2013
<b>shum</b>								<b>1,537,398</b>	<b>1,054,223</b>	

### Tarifat e shkollimit

Për vitin akademik 2011-2012, paraqiten si më poshtë

Nr studenteve gjithsej 868 persona

Kane likuiduar tarifën 755 persona

Nga këta:

- Me arkëtim ne arkë 00 persona
- Me banke 755 persona

Nr i studenteve që nuk kanë paguar tarifë shkollimi 113 persona. Nga këta:

- Të persekutuar që përjashtohen nga detyrimi 38 persona
- Rom që përjashtohen nga detyrimi 16 persona
- Student me rezultate larta, përjashtohen nga detyrimi 12 persona
- Te verbër 3 persona
- Te tjerë që sipas legjislacionit përjashtohen nga detyrimi 16 student
- Janë larguar 28 student.

Për vitin akademik 2012-2013, paraqiten si më poshtë:

Nr studenteve gjithsej 1012 persona

Kane likuiduar tarifën 845 persona

Nga këta:

- Me arkëtim ne arkë 0 persona
- Me banke 845 persona

Nr i studenteve që nuk kanë paguar tarifë shkollimi 167 persona. Nga këta:

- Të persekutuar që përjashtohen nga detyrimi 12 persona
- Romë që përjashtohen nga detyrimi 26 persona
- Student me rezultate larta, përjashtohen nga detyrimi 16 persona
- Te verbër 1 persona
- Te tjerë që sipas legjislacionit përjashtohen nga detyrimi 49 student
- Janë larguar 63 student.

Në mënyrë analitike informacioni për tarifat e shkollimit është sipas pasqyrave pjesë e dosjes së auditimit.

#### **4.-AUDITIMI I BLERJEVE DHE PROKURIMEVE.**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2012 janë planifikuar prokurime gjithsej 43.723 mije lekë, nga të cilat 29.503 mijë lekë nga zëri shpenzime operative(602) dhe 14.220 mijë lekë nga zëri investime (231).

Sipas regjistrit të prokurimit janë planifikuar 4 (katër) procedura prokurime të cilat janë planifikuar me procedurën “tender i hapur” dhe janë realizuar tre procedura si më poshtë:,

- Dy prokurime me procedurën “tender i hapur”
- Një prokurime me procedurën “negocim pa shpallje”

Vlera e realizuar e kontratave është 11.570 ose 3.178 mije lekë më pak se fondi limit i planifikuar.

Për vitin 2013 janë planifikuar prokurime gjithsej 32,825 mije lekë, nga të cilat 30.231 mijë lekë nga zëri shpenzime operative(602) dhe 2.534 mijë lekë nga zëri investime (231)

Për vitin 2013 janë planifikuar tre procedura prokurime dhe janë realizuar pesë, nga të cilat:

- Një prokurim me procedurën “tender i hapur” i përqendruar,
- Dy prokurime me procedurën “tender i hapur”
- Dy prokurime me procedurën “negocim pa shpallje”

Janë realizuar 5(pesë) procedura me vlerë të kontratave 6.343 mijë lekë ose 1.601 mijë lekë më pak nga vlera limit e planifikuar.

Për të gjithë praktikat e audituara procedura e prokurimit është përcaktuar sipas fondit të vënë në dispozicion dhe dokumentacioni ligjor u gjet sipas ligjit.

## **5.- AUDITIMI I INFORMACIONIT FINANCIAR.**

Drejtimi ka vlerësuar drejtë përdorimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe specifikisht përdorimin e sistemeve kompjuterike financiare. Ne këtë drejtim është parashikuar aplikimi i programeve informatikë ne menaxhimin e sistemit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet e regjistruara janë klasifikuar dhe u është vënë kodi i saktë në regjistrimet kontabile.

Vlerësojmë se ka një sistem të mirë përcaktuar në evidencën kontabile dhe të raportimit financiar.

Angazhimi i drejtimit për të projektuar dhe mbajtur sisteme të besueshme të kontabilitetit vlerësohet optimal.

Ne kemi audituar bilancin kontabël për ushtrimin e mbyllur më datë 31 dhjetor 2012 dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave dhe të fluksit të parasë për këtë periudhë.

Rezulton se nga krahasimi i rubrikave në dy periudhat përkatëse ka ndryshime të ndjeshme.

Nga analiza që ju bë kësaj shtate rezultoi se ndryshimet janë plotësisht të justifikuara dhe pa anomali.

U bë verifikimi aritmetikor i ditarit, Librit të Madh dhe centralizatorit, vertikalisht dhe horizontalisht – nuk pati diferenca.

Të gjitha regjistrimet janë të mbështetur mbi dokumente justifikues baze dhe që ju referohen operacioneve ekonomike të ndodhura dhe të mara në kontabilitet gjatë periudhës.

U bë verifikimi i shumave të bilancit të çeljes me ato të mbylljes të ushtrimit paraardhës dhe nuk pati devijime.

U bë vlerësimi i elementëve ekstra kontabël si inventarët, skedat e aktiveve të qëndrueshme, skeda e stokut si dhe analizat e llogarive sintetike dhe nuk rezultuan anomali materiale.

Inventarizimi i vlerave materiale është bërë në mënyrë të rregullt dhe janë nxjerrë rezultatet, duke zbatuar kështu kërkesat e ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, kreu V. Me urdhrin nr. 120 datë 10.12.2012 të rektorit ka filluar procesi për kryerjen e inventarëve të magazinës dhe objekteve të universitetit. Urdhri përmban krijimin e komisioneve të kryerjes së inventarit dhe afati i fillimit dhe mbarimit të

secilit prej tyre. Sipas procesverbalit të komisioneve rezulton se nuk ka diferenca në inventarin ekonomik.

Procedura vlerësohet e rregullt dhe në përputhje me VKM nr. 70, datë 11.03.1985 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe çarkullimin e vlerave materiale e monetare" pika III dhe aktet normative në fuqi.

## **6. AUDITIMI I PËRDORIMIT TË FONDEVE PËR BURSAT**

Në mbështetje të VKM nr. 759 date 05.10.2010 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2010-2011" dhe shkresës të MASH-it, është ngritur Komisioni i vlerësimit të dokumentacionit të bursave me urdhër te rektorit me nr.785, datë 15.10.2010 "Mbi caktimin e komisionit të shqyrtimit të dokumenteve të bursave të studentëve të vitit të dytë e lartë për vitin akademik 2010-2011" i cili ka shqyrtuar dokumentacionin e bursave të studentëve brenda afatit të përcaktuar. Me vendim te komisionit, "për miratimin e bursave të studentëve të vitit II, III, IV", kanë përfituar bursë studentët si më poshtë.

### ***Për vitin akademik 2011-2012***

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>½ burse</b>	<b>Bursa te plota</b>	<b>Total te konvertuar ne bursa te plota</b>
1	Studente viti I	12	13	19.0
2	Studente viti II	14	11	18.0
3	Studente viti III	3	22	23.5
	<b>Totali</b>	<b>41</b>	<b>59</b>	<b>54.5</b>

Për studentët e vitit të parë, dokumentacioni u gjet në përputhje me kërkesat e VKM, nr.759 date 05.10.2010 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2010-2011" si vendimet e pushtetit vendor, konfirmimi dhe lista nga drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

**Për vitin akademik 2012-2013**


<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>½ burse</b>	<b>Bursa te plota</b>	<b>Total te konvertuar ne bursa te plota</b>
1	Studente viti I	10	5	10.0
2	Studente viti II	12	12	18.0
3	Studente viti III	12	14	20.0
	<b>Totali</b>	<b>41</b>	<b>59</b>	<b>48.0</b>

Gjatë periudhës 2 vjeçare, 2012-2013, në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimeve me institucione të artit jashtë kufijve me qëllim përmirësimin dhe pasurimin e programeve të studimit që ofron Universiteti i Arteve në Tiranë, janë kryer shpenzime për udhëtime të ndryshme jashtë vendit.


Sipas informacionit të paraqitur nga Dega e Marrëdhënieve me jashtë rezulton se shpenzimet e kryera për udhëtime jashtë shtetit kanë justifikuar qëllimin, kanë qenë efektive dhe në dobi të Universitetit

**GRUPI I AUDITIMIT**

**Vjollca HAXHIU**



**Jeton SHEHU**



Tiranë më 26.01.2014